

(Sipas Vendimit nr. 204, date: 30.03.2026)

RAPORT TEKNIK

Hartimi I Projektit Dhe Preventivit Për Ndërtimin E Spitalit Për Persona Me Mjekim Te Detyruar Me Vendim Gjykatë Në Ievp Shënkoll, Lezhë”me Zhvillues Drejtoria e Pergjitheshme e Burgjeve

Shtojca II, Pika 10. Prodhime infrastrukturore b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkimet për makinat.

ME ZHVILLUES SUBJEKTI: DREJTORIA PERGJITHESHME E BURGJVE

Adresa: Lezhe

Pergatiti: Ing.Erjona Qatipi

Nr. Certifikate 5012 dt. 04/07/2013

Tirane 2026

P Ë R M B A J T J A

➤ Hyrje



1. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

2

- a) Qellimi i projektit te propozuar; 2
- b) Planimetria e vendodhjes se projektit, ku pasqyrohen ne harte topografike kufijte e siperfaqes, te shoqeruar me kordinatat sipas sistemit Gaus Kruge, fotografi dhe te dhena per perdorimin ekzistues te siperfaqes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo funksionimit te veprimtarise; 3
- c) Informacion per qendrat e banuara, ne zonen ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar me fotografi dhe te dhena per distancen e tyre nga vendodhja e propozuar, si edhe percaktimin e njesise Vendore qe administron territorin ku propozohet projekti; 7
- ç) Pershkrimi i proceseve ndertimore dhe teknologjike, perfshire kapacitetet prodhuese, sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit; 7
- d) Informacion per infrastrukturen e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojen per hapje te rrugeve te reja; 11
- dh) Programin per ndertimin, kohezgjatjen e planifikuar per funksionimin e projektit, kohen e mundshme te perfundimit te funksionimit te prjektit dhe sipas rastit edhe fazen e planifikuar te rehabilitimit te siperfaqes, pas mbarimit te funksionimit te projektit; 12
- e) Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materiale ndertimi, uje dhe energji); 12
- ë) Informacioni per lidhjet e mundshme te projektit me projekte te tjera ekzistuese perreth/ prane zones se projektit; 12
- f) Informacion per alternativat e marra ne konsiderate, per sa i takon perzgjedhjes se vendndodhjes se projektit dhe teknologjiise qe do te perdoret; 13
- g) Te dhenat per perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit, perfshire sasite e ujit te nevojshem, te energjiise, lendeve djegese dhe menyren e sigurimit te tyre; 13
- h) Te Aktivitete te tjera qe mund te nevojiten per zbatimin e projektit, si ndertimi i kampeve apo rezidencave etj; 13
- i) Informacion per lejet, autorizimet dhe licensat e nevojshme per projektin ne perputhje me percaktimet e bera ne legjislacionin ne fuqi si dhe institucionet kompetente per lejimin, autorizimin, licensimin e projektit; 13
- j) Te dhena per perdorimin ekzistues te siperfaqes se tokes ku do te zhvillohet projekti; 14

➤ Hyrje

Në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme për modernizimin dhe përafrimin e sistemit penitenciar shqiptar me standardet ndërkombëtare, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) ka ndërmarrë një nismë të rëndësishme reformuese për të transformuar Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP). Kjo Detyrë Projektimi i drejtohet projektimit të një Spitali Qendror Penitenciar të ri dhe modern, i cili do të shërbejë si qendra kryesore e referencës për kujdesin shëndetësor spitalor dhe specialist për të gjithë popullatën e burgjeve në vend, me një kapacitet të parashikuar shërbimi prej rreth 4000+ të dënuarve të të gjitha kategorive. Zgjidhjet e propozuara në këtë fazë përbëjnë bazën konceptuale mbi të cilën do të ndërtohen fazat e mëtejshme të projektimit, duke u thelluar në dimensionimin teknik, strukturor dhe inxhinierik të objektit, si dhe në përputhshmërinë e plotë me kërkesat ligjore dhe normative në fuqi për objektet spitalore dhe institucionet penitenciare.. Janë planifikuar lidhje jetësore (ujë, kanalizime, energji elektrike, gaz, etj.) për të gjitha nevojat *Ndërtimin E Spitalit Për Persona Me Mjekim Te Detyruar Me Vendim Gjykatë Në Ievp Shënkoll, Lezhe* me Zhvillues Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve .Trualli ka sipërfaqe rreth 80,423 m², me gjurmë ekzistuese ndërtimi rreth 7,860 m².

➤ PERSHKRIMI I PROJEKTIT

a) Qëllimi i projektit të propozuar

Qëllimi i këtij aktiviteti është mbi vlerësimin e përgjithshëm, të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore, të projekteve që do të zbatohen duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis me qëllim mbrojtjen e mjedisit nga ndotja. Të gjitha proceset e punës që nga sigurimi i lëndëve të para e deri në përfundim do të zbatohen konform akteve ligjore në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij.

Specifikisht klasifikohet në **Shtojca II, Pika 10. Prodhime infrastrukturore b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkimet për makinat.**

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, kërkon të realizojë projektin kërkon të realizojë projektin e zbatimit (studim projektimit) për objektin *Ndërtimin E Spitalit Për Persona Me Mjekim Te Detyruar Me Vendim Gjykatë Në Ievp Shënkoll, Lezhe* me Zhvillues *Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve*, me Vendndodhje Në Njësinë Strukturore **Nr. 219/50, Nr. 218/1 dhe Nr. 343**, Bashkia Lezhe. Koncepti i planifikuar i objektit përfshin ndërtimin e një Spitali Penitenciar. Çdo njësi funksionale do të ndahet në zona që janë Godina e Spitalit, Godina e Pavijonit, Kuzhina. Kompleksi ndahet në zona funksionale të qarta: zonë spitalore; zonë pavijoni; zonë teknike; zonë administrative; zonë rekreative e kontrolluar. Programi funksional i kompleksit Spitalor Penitenciar në IEVP Shënkoll është konceptuar si një strukturë e integruar që kombinon funksionin klinik, kërkesat e sigurisë penitenciare dhe autonominë teknike të institucionit

RAPORT TEKNIK

- b) Planimetria e vendodhjes se projektit, ku pasqyrohen ne harte topografike kufijte e siperfaqes, te shoqeruar me kordinatat sipas sistemit Gauss Kruger, fotografi dhe te dhena per perdorimin ekzistues te siperfaqes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo funksionimit te veprimtarise.

Planvendosja e objektit







Tabela Nr. 1 Koordinatat e zones sipas sistemit GAUS GRUGER

Nr.	E	N
1	4388229.84	4617599.81
2	4388278.16	4617599.95
3	4388326.06	4617625.65
4	4388339.26	4617616.04

Tabela Nr.2. Kordinatat e zones sipas sistemit KRGJSH

Nr.	E	N
1	471359.13	4616652.55
2	471407.43	4616653.25
3	471455.03	4616679.50
4	471468.33	4616670.05


PLAN SISTEMIMI I OBJEKTIT**PLANI I SISTEMIMIT**

PLANET 3-DIMENSIONALE










Ne ortofoton me poshte tregon projektin qe nuk ndodhet ne zone te mbrojtur.

Projekti ka për qëllim Hartimi I Projektit Dhe Preventivit Për Ndërtimin E Spitalit Për Persona Me Mjekim Te Detyruar Me Vendim Gjykatë Në Ievp Shënkoll, Lezhe”me Zhvillues Drejtoria e Pergjitheshme e Burgjeve

- c) Informacion per qendrat e banuara, ne zonen ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar me fotografi dhe te dhena per distancen e tyre nga vendodhja e propozuar, si edhe percaktimin e njesise Vendore qe administron territorin ku propozohet projekti.**

Sheshi i propozuar i ndërtimit ndodhet në një zonë në zhvillim e sipër, në afërsi të menjëhershme të infrastrukturës urbane ekzistuese të qytetit të Lezhës. Zona nuk karakterizohet nga vendbanime rurale të izoluara, por është pjesë integrale ose zgjatim i zonës së banuar urbane. Zona karakterizohet kryesisht nga toka bujqesore ndersa objektet e banimin jane ne nje distance te konsiderueshme nga vendi ku do te ndertohet ***Hartimi I Projektit Dhe Preventivit Për Ndërtimin E Spitalit Për Persona Me Mjekim Te Detyruar Me Vendim Gjykatë Në Ievp Shënkoll, Lezhe”me Zhvillues Drejtoria e Pergjitheshme e Burgjeve***

- Distancat minimale midis ndertimeve.
- Distancat e lejuara midis ndertimit dhe kufirit te prones.
- Distancat ndermjet ndertimit dhe kufirit te trupit te rruges



c) Pershkrimi i proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese, sasitë e lendeve të para dhe produktet përfundimtare të projektit.

Proçeset teknologjike në këtë projekt janë ato të fazës ndërtimore, nëpërmjet punimeve të ndërtimit të cilat do të kryhen nga subjektet zbatuese të projektit. Disa prej proceseve kryesore të punimeve ndërtimore do të jenë:

- ❖ Rrethimi i sheshit të ndërtimit;
- ❖ Pastrimi i sheshit dhe përgatitja e tij për ndërtim;
- ❖ Germimi apo hapja e themeleve të strukture së objektit;
- ❖ Betonimi i themeleve;
- ❖ Ngritja e strukture prej betoni (betoni blihet i gatshëm nga prodhues të licensuar)
- ❖ Muratura, instalimet inxhinierike, termoizolimi, suvatimet
- ❖ Sistemimi i sheshit rreth objektit, rruget hyrese-dalese;
- ❖ Rehabilitimi i hapsirave sipas planit të sistemimit të objektit të projektuar;

Ngritja e Kantierit

Në këtë projekt përmbledhen një numër i madh detyrash pa të cilat nuk mund të arrihet zhvillimi normal i punimeve në sheshin e ndërtimit. Rrethimi i përkohshëm i sheshit të ndërtimit gjatë periudhës së zhvillimit të punimeve është i domosdoshëm. Ky rrethim i bëhet zonës së ndërtimit për

të mbrojtur kalimtarët dhe për të evituar të papriturat që mund të vijnë nga mjetet dhe mekanizmat që kryejnë punimet. Rrethimi shërben dhe për të ruajtur materialet që përdoren në vepër si edhe punimet e kryera. Rrethimet e përkohshme zbatohen të thjeshta por të qëndrueshme më parë. Ky rrethim mund të bëhet duke përdorur materiale të përdorura më parë. Struktura kryesore e ndërtesës është një sistem skeletor i parafabrikuar me beton të armuar, mbi themele individuale monolite që lidhen me trarë themeli BA të parafabrikuar përgjatë perimetrit (në fasadë). Kjo strukturë e re do të shërbejë si ***Hartimi I Projektit Dhe Preventivit Për Ndërtimin E Spitalit Për Persona Me Mjekim Te Detyruar Me Vendim Gjykatë Në Ievp Shënkoll, Lezhe*** me Zhvillues Drejtoria e Pergjitheshme e Burgjeve. Projektimi është bërë duke patur si objektiv kryesor mbrojtjen e strukturës kundrejt dy kushteve limite: kushtet kufitare të projektimit për elementët jo strukturor, që është me pasoja dhe natyrë ekonomike, dhe kushtet kufitare të projektimit për elementët struktural që kanë në shembjen totale të strukturës. Projektimi i strukturës është bazuar në konceptin e performancës në të cilën vlerësohet jeta njerëzore, dhe në të njëjtën kohë vlerësimi nga ana ekonomike e vet projektit.

Lëndët e para

Lëndët e para që do të përdoren do të jenë kryesisht elementet si: betoni dhe llaçi të cilët do të blihet të gatshëm nga firma të licensuara, hekuri për strukturën mbajtëse të objektin, dyer e dritare fasadë, duralumini dhe xham të përgatitura edhe këto në bazë të formës dhe madhësisë që kërkon projekti nga subjekte të licensuara, tulla për muret ndarëse, kartonxhes dhe gips sipas kërkesës për modifikime të brendshme ose dhe për zbukurime. Struktura druri për hijezim dhe këto do të blihen në subjekte të licensuara.

Lëndë të para ndihmese naftë dhe vajra lubrifikante për makineritë që do të transportojnë lëndën e parë. Kamiona vetshkarkues dhe vinca për transportin, shkarkimin dhe vendosjen e profileve metalike për ngritjen e strukturës. Betoniere që do të shërbejnë për transportin e betonit për ndërtimin e plintave (themeleve) dhe soletat e ndërkatit. Energji elektrike nga rrjeti për ndriçim dhe sipas rastit dhe nevojës që do të ketë në objekt edhe për shërbime të tjera. Ujë për lagjen e shesheve që të mos krijohen pluhura sidomos në kohë të thatë dhe me erë.

Mbetjet e prodhuara nga aktiviteti ndërtues

Veprimtaria e këtij aktiviteti do të shoqërohet me këto lloj mbetjesh:

- Mbetje të ngurta nga gërmimet dhe mbetje të ngurta inerte
- Mbetje urbane nga aktiviteti njerëzor i punëtorëve

Mbetjet e ngurta nga gërmimet dhe inerte

Mbetjet e dala nga gërmimet do të depozitohen në zonën anash ndërtimit të objektit 1 kat dhe do të përdoren si mbushës gjatë fazës së ndërtimit. Pjesa tjetër do të sistemohet në venddepozitimet e caktuara nga pushteti vendor me nënkontraktor të tretë të cilët duhet të jenë të licensuar për transportin e këtyre mbetjeve. Për sa i përket mbetjeve inerte, ato janë në sasi të pakonsiderueshme.

Mbetjet e ngurta urbane

Gjatë fazës së ndërtimit, mbetjet e ngurta urbane do të gjenerohen si rezultat i aktivitetit ditor të personelit të angazhuar në kantier. Këto mbetje përfshijnë kryesisht mbetje të zakonshme të tipit shtëpiak, si ambalazhe plastike, letër, karton dhe mbetje ushqimore. Menaxhimi i tyre do të realizohet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Grumbullimi do të kryhet në kontejnerë të përshtatshëm, të mbyllur dhe të vendosur në zona të dedikuara brenda kantierit, duke shmangur shpërndarjen e tyre në mjedis. Mbetjet do të largohen në mënyrë periodike dhe do të transportohen drejt venddepozitimeve të miratuara, përmes shërbimit publik të njësisë vendore ose operatorëve të licencuar. Zbatimi i këtyre masave siguron kontrollin e ndikimeve në mjedis, parandalon ndotjen dhe garanton kushte të përshtatshme higjieno-sanitare gjatë zhvillimit të punimeve.

Rrjeti elektrik

Duke qenë se objekti klasifikohet si **infrastrukturë kritike** dhe me kërkesa të dyfishta (spitalore + penitenciare), **garantimi i energjisë elektrike** trajtohet si element themelor i sigurisë dhe vazhdimësisë së shërbimit. Detyra e Projektimit/Analiza e saj kërkon që kompleksi të funksionojë si **“ishull” në rast krizash**, me **gjeneratorë që mbulojnë 100% të nevojave për energji**, në mënyrë që shërbimet kritike të mos ndërpriten. **Vazhdimësi 24/7** të shërbimeve shëndetësore dhe të sigurisë (CCTV, kontroll aksesit, sistemet e dymve, ndriçim sigurie, komunikime, servera/TIK, pajisje mjekësore kritike, pompime ujë/ujë zjarri, ventilim minimal).

Autonomi operationale për një periudhë të përshtatshme që lejon: (i) riparimin e defekteve në rrjet, (ii) menaxhimin e emergjencave dhe (iii) evakuimin e kontrolluar/operimin në regjim incidenti (pa komprometuar sigurinë). **Ndërprerje të pranueshme minimale** (UPS për ngarkesat “pa ndërprerje”; gjenerator për ngarkesat “kritike”; rrjet publik për ngarkesat “normale”). Në kushtet e sitit, lidhjet me rrjetin elektrik paraqiten si pikë kritike dhe kërkojnë zgjidhje me redundancë reale (jo vetëm një burim). Kjo është e rëndësishme sepse defektet në linja/elementë të rrjetit mund të shkaktojnë ndërprerje të gjata dhe ndikim të drejtpërdrejtë në funksionin spitalor e penitenciar. Aktualisht IEVP Shënkoll furnizohet nga nënstacioni 10KV i Rilës që është nënstacioni i cili furnizohet nga NST i Fushe Kuqes. Gjate përmytjeve NST Fushe Kuqe paraqet shume problematika dhe është i detyruar te stakojë energjinë duke sjelle direkt mungese furnizimi ne zone dhe IEVP. Dy furnizime të pavarura në nivelin e tensionit të mesëm (p.sh. 10 kV), me logjikë N-1 (një burim mund të bjerë pa ndërprerë funksionimin kritik). Fider i dedikuar (linjë e re) si linjë e dytë/rezervë, me nyje pritëse dhe celula të dedikuara, për të rritur sigurinë e furnizimit dhe për të ulur varësinë nga një konfigurim i vetëm rrjeti. Kabina/nënstacioni i brendshëm (RMU/celula MV + transformatorë) i konceptuar me ndarje funksionale dhe mundësi izolimi të defektit, duke garantuar selektivitet mbrojtës dhe rikthim të shpejtë në punë. Ky nuk është investim që mund të mbulohet plotësisht nga buxheti i DPB apo i IEVP Shënkoll, por në bashkëpunime me OST/ OSSH dhe Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës duhet te koordinohet për te garantuar një furnizim nga NST Lezhe ne nivel 20KV si dhe një kabine te dyte për IEVP dhe ose zonën e Shënkollit.

Infrastruktura e ujit të pijshëm dhe ujit për shërbime

Furnizimi me ujë trajtohet si infrastrukturë kritike për operimin e kompleksit spitalorpenitenciar, për shkak të kërkesave të larta dhe të pandërprera për: **ujë të pijshëm**, **ujë higjieno-sanitar** (dusha, tualete, lavanderi), **ujë për shërbime spitalore** (pastrim, dezinfektim, sterilizim sipas nevojës), **ujë për kuzhinën** (përgatitje, larje, higjienë), si dhe **ujë për sistemet teknike** (p.sh. zjarri, ftohje/ndihmëse teknologjike sipas zgjidhjeve MEP). Në gjendjen ekzistuese, kompleksi mbështetet në **puse** dhe menaxhim të ujërave të ndotura me **gropa septike/evakuim**, çka nuk përputhet me logjikën e një strukture spitalore dhe kërkon një zgjidhje të re të integruar.

Parashikohet një sistem furnizimi që garanton **siguri, vazhdimësi dhe kontroll cilësie**, i organizuar në parime të qarta:

- **Ndarje funksionale e linjave:** ujë i pijshëm dhe ujë për shërbime (higjieno-sanitar/kuzhinë/pastrime), me skema të tilla që lejojnë kontroll, monitorim dhe izolim të segmenteve në rast avarie.
- **Rezervë dhe autonomi:** depozita ujore të dimensionuara për të mbuluar konsumin ditor dhe skenarët e emergjencës (avari në furnizim, kufizime në rrjet, kushte të jashtëzakonshme), duke mundësuar operim të qëndrueshëm deri në riparim të defekteve ose rikthim normal të furnizimit.
- **Trajtim dhe kontroll cilësie:** filtrime/klorinim dhe monitorim i parametrave bazë të ujit sipas nevojave të funksionit, në mënyrë që furnizimi të jetë I përshtatshëm për përdorim njerëzor dhe shërbime të kuzhinës/spitalit.
- **Presion i qëndrueshëm dhe redundancë pompimi:** grupe pompash me konfigurim rezervë (N+1 ose N-1) për të garantuar furnizim të pandërprerë në pikat kritike, veçanërisht në shërbime spitalore, kuzhinë dhe zona higjienosanitare.
- **Uji për mbrojtje nga zjarri:** rezervë dhe rrjet i dedikuar (sipër konceptit, detajimi në MEP), si pjesë e sigurisë së kampusit dhe operimit në emergjencë.

Produkti perfundimtar i këtij projekti do të jete ndertimi I Hartimi I Projektit Dhe Preventivit Për Ndërtimin E Spitalit Për Persona Me Mjekim Te Detyruar Me Vendim Gjykatë Në Ievp Shënkoll, Lezhe”me Zhvillues Drejtoria e Pergjitheshme e Burgjeve

- d) **Informacion per infrastrukturen e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojen per hapje te rrugeve te reja.**

Pozicioni gjeografik, përshkrimi i rilievit, proceset fiziko-gjeologjike dhe gjeodinamike, ndërtimi gjeologjik dhe hidrologjik, depozitimet, kushtet gjeologjike, karakteristikat fiziko-mekanike të shtresave gjeologjike për ndërtimin e **“Hartimi I Projektit Dhe Preventivit Për Ndërtimin E Spitalit Për Persona Me Mjekim Te Detyruar Me Vendim Gjykatë Në Ievp Shënkoll, Lezhe”me Zhvillues Drejtoria e Pergjitheshme e Burgjeve** materialet e ndërtimit, të dhënat teknike për çdo proces të kësaj infrastrukture ndërtimore, janë të pasqyruara me hollësi e të përshkruara në detaje në relacionet teknike përgatitur nga specialist të licensuar përgatitur me kërkesë të zhvilluesit.

Furnizimi me energji

Furnizimi me energji elektrike i objektit do të realizohet nga rrjeti shpërndarës i zonës, nën administrimin e OSSH (Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike), Njësia Lezhë. Për këtë qëllim, subjekti do të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për lidhjen e kontratës së furnizimit, konform rregullave dhe kriterëve teknike të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Furnizimi me uje

Furnizimi me ujë për objektin do të realizohet nga rrjeti publik i ujësjellësit, nën administrimin e Ujësjellës Kanalizime Lezhë (UK Lezhë). Subjekti do të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për lidhjen me rrjetin ekzistues dhe do të pajiset me kontratë të rregullt furnizimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për të garantuar furnizim të vazhdueshëm dhe të sigurt me ujë, veçanërisht duke marrë parasysh funksionin e objektit si institucion shëndetësor, projekti parashikon:

Rezervuarë uji (depozita): Instalimin e depozitave rezervë për të siguruar furnizim të pandërprerë në rast ndërprerjeje të përkohshme nga rrjeti publik.

Sistemi i pompimit: Vendosjen e pompave për shpërndarjen e ujit në të gjitha nivelet e ndërtesës, duke garantuar presionin e nevojshëm për funksionimin normal të pajisjeve sanitare dhe mjekësore.

Ujë për mbrojtje nga zjarri: Parashikimin e një linje të veçantë për furnizimin e sistemit kundër zjarrit (hidrantë të brendshëm dhe të jashtëm), në përputhje me normat teknike në fuqi.

Ky sistem siguron që objekti të ketë furnizim të qëndrueshëm dhe të kontrolluar me ujë, duke përmbushur kërkesat higjeno-sanitare dhe funksionale të një institucioni spitalor.

Shkarkimet e ujerave te ndotura

Nuk do të kemi ndotje të ujërave nëntokësore, ujërat që dalin nga aktiviteti i ndërtimit të objektit janë ujëra të cilat lindin si rrjedhojë e aktivitetit të lagies së kantierit, larjes së gomave të automjeteve dhe ujërat e reshjeve nga kushtet atmosferike. Gjithsesi, punimet e ndërtimit nuk duhet të tejzgjaten dhe të kalojnë afatet e përcaktuara në lejen e ndërtimit. Nuk duhet të shkarkohen lëndë të dëmshme në mjedisin e kantierit pasi nuk mund të filtrojnë së bashku me ujërat e reshjeve dhe si rrjedhojë të ndosin ujërat nëntokësore. Në kantier nuk duhet të magazinohen materiale të rrezikshme dhe si rrjedhojë nuk vlerësohet të ketë ndotje të ujërave nëntokësore ose sipërfaqësore. Mundësitë e ndotjes, mund të vijnë vetëm nga derdhja e hidrokarbureve ose lubrifikantëve gjatë furnizimit të mjeteve të rënda të punës. Një faktor tjetër mund të jenë ujërat e pastrimit e të larjes së kazanëve të betoniereve gjatë shkarkimit të betonit në kantier. Këto të fundit, nuk duhet të shkarkojnë ujërat në çdo mjedis rrethor, ato duhet të shkarkohen në mjedise të caktuara dhe në kantierët e prodhimit të betonit. Punimet e themeleve do të jenë për një periudhë kohore tepër të shkurtër dhe mundësia e këtyre ujërave zvogelohet ndjeshëm. Gjatë funksionimit të objektit, shkarkimet në ujëra do të jenë vetëm ato të larjes e pastrimit të ambjenteve dhe nga nyjet higjeno-sanitare. Këto ujëra do të shkarkohen në rrjetin e kanalizimeve të zonës.

Grumbullimi i mbetjeve të ngurta, dhe ato urbane

Grumbullimi dhe menaxhimi i mbetjeve të ngurta, përfshirë ato urbane, do të realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbetjeve. Mbetjet do të ndahen që në burim sipas kategorive (urbane, të riciklueshme dhe mbetje të tjera të veçanta), duke u depozituar në kontejnerë të mbyllur dhe të përshtatshëm, të vendosur në pika të dedikuara brenda territorit të objektit. Mbetjet urbane do të mbledhen dhe transportohen periodikisht nga shërbimi publik i Bashkisë Lezhë drejt venddepozitimit të autorizuar. Për shkak të natyrës së objektit, mbetjet spitalore do të trajtohen veçmas sipas protokolleve përkatëse, duke u grumbulluar në kushte të sigurt dhe duke u dorëzuar tek operatorë të licencuar për trajtimin e tyre. Ky sistem siguron menaxhim të kontrolluar të mbetjeve, duke minimizuar ndikimin në mjedis dhe rreziqet për shëndetin publik.

Rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja

Infrastruktura është ekzistuese kështu që nuk është e nevojshme hapja e rrugëve të reja.

dh) Programin për ndertimin, kohezgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohen e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe sipas rastit edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit.

Punimet ndërtimore mund të zgjasin për një periudhë afërsisht 30 muaj. Kjo sipas grafikut të punimeve të parashikuar, dhe është një kohë normale për të përfunduar se ndërtuari këtë ***Për Ndërtimin E Spitalit Për Persona Me Mjekim Te Detyruar Me Vendim Gjykatë Në Ievp Shënkoll, Lezhë*** me Zhvillues Drejtoria e Pergjitheshme e Burgjeve. Kjo vlen nëse kushtet teknike, juridike e klima është normale, por nëse gjatë punimeve do të hasen vështirësi edhe mund të shtyhen afatet e përcaktuara.

Si rrjedhojë ndikimet e fazës ndërtimore do të zgjasin për aq kohë sa do të zgjasi edhe punimet ***Për Ndërtimin E Spitalit Për Persona Me Mjekim Te Detyruar Me Vendim Gjykatë Në Ievp Shënkoll, Lezhë*** me Zhvillues Drejtoria e Pergjitheshme e Burgjeve. Ndikimet në peisazh do të jenë të përkohëshme për fazën e ndërtimit të strukturës e cila me pas do të ketë një pamje vizualisht të këndshme për syrin e njëriut. Nuk shkarkohen elementë të dëmshëm për mjedisin, si në atë ujor, në ajër, tokë dhe në biodiversitet. Në përfundim të ndërtimit shoqëria ndërtuese do të kryej edhe rehabilitimin e hapsirës përreth dhe gjelbërimin e saj. Mbjellja e pemëve dhe sistemimi i dherave ndihmon ndjeshëm në eliminimin e dëmtimeve dhe rehabilitimin e peisazhit. Me përfundimin e ndërtimit të objektit ai do të funksionoj si institucion shëndetësor penitenciar (Spital) i cili përbehet nga disa njësi funksionale që mund të ndertohen në fazë.

e) Informacioni për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/ pranë zones së projektit.

Ndërtimi i këtij projekti do të sjelli bashkpunimin e punës së investitorit me subjektin projektues, ndërtues, ekspertin e mjedisit, institucionet përgjegjëse të OSSH, Ujesjellës-Kanalizimeve, rrjetit të telefonisë wi-fi, për të bërë të mundur lidhjen e energjisë elektrike, ujit, si dhe lidhjen për shkarkimin e ujërave.

f) Informacion për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon perzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret.

Perzgjedhja e vendndodhjes së projektit në fjalë ka ardhur si pasoje e vendndodhjes së tij dhe aksesit që ka me rrugët lidhëse dhe pronesitë të vendit ku do të ndërtohet projekti *Ndërtim I Spitalit Për Persona Me Mjekim Te Detyruar Me Vendim Gjykatë Në Ievp Shënkoll, Lezhë* me Zhvillues Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

g) Te dhënat për përdorimin e lendeve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lendeve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre.

Gjatë fazës së ndërtimit të objektit “Ndërtimi i Spitalit për Persona me Mjekim të Detyruar me Vendim Gjykatë në Ievp Shënkoll, Lezhë”, me zhvillues Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, lëndët e para që do të përdoren do të jenë kryesisht materialet e ndërtimit të nevojshme për realizimin e strukturës, ndërsa lëndët ndihmëse do të përfshijnë ujin, energjinë elektrike dhe produkte të konsumit të përditshëm. Energjia elektrike gjatë fazës së ndërtimit do të sigurohet nga rrjeti ekzistues i zonës, përmes lidhjes me OSSH, në përputhje me procedurat dhe legjislacionin në fuqi. Uji për nevojat teknologjike gjatë ndërtimit do të sigurohet përmes depozitave të vendosura nga shoqëria ndërtuese. Në përfundim të projektit, objekti do të furnizohet me ujë nga rrjeti publik i ujësjetillës të zonës, nëpërmjet një kontrate të rregullt me UK Lezhë, ndërsa furnizimi me energji elektrike do të vijojë nga rrjeti shpërndarës përkatës. Sistemet teknike, përfshirë furnizimin me ujë, pikat e lidhjes, prurjet dhe llogaritjet hidraulike, rrjetin e ujërave të përdorura dhe lidhjen me sistemin e ujësjetillës-kanalizimeve, si dhe sistemet e ngrohjes dhe ventilimit, do të projektohen dhe përcaktohen nga specialistët përkatës, në përputhje me projektet teknike të miratuara.

h) Aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.

Gjatë fazës së ndërtimit të propozuar nuk nevojiten ndërtime për kampe apo rezidenca për punëtorët pasi nuk do të jetë nevojë sepse punëtorët do të merren nga zonat në afërsi të vendit ku do të ndërtohet projekti. Përveç projektit në fjalë, nuk ka asnjë produkt tjetër ndërtimor ose infrastrukturor që zhvillohet në këtë zonë dhe që mund të kondiciononte në ecurinë dhe kohëzgjatjen e objektit.

i) Informacion per lejet, autorizimet dhe licensat e nevojshme per projektin ne perputhje me percaktimet e bera ne legjislacionin ne fuqi si dhe institucionet kompetente per lejimin, autorizimin, licensimin e projektit.

Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 204, datë 30.03.2026, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive dhe të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore”, i ndryshuar, zhvilluesi i projektit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, do të angazhojë subjektet përkatëse (studio projektimi dhe ekspert mjedisi) për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për pajisjen me Vendim Mjedisor (VNM Paraprake), në përputhje me legjislacionin në fuqi. Aktualisht, projekti ndodhet në fazën e përgatitjes dhe nuk është pajisur ende me leje, autorizime apo licenca për ndërtim. Pas marrjes së Vendimit Mjedisor nga autoriteti kompetent, subjekti do të vijojë procedurat për aplikimin dhe pajisjen me Leje Ndërtimi pranë institucioneve përkatëse, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

j) Te dhena per perdorimin ekzistues te siperfaqes se tokes ku do te zhvillohet projekti.

Sipërfaqja e tokës ku propozohet zhvillimi i projektit ndodhet brenda perimetrit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Shënkoll, Lezhë. Aktualisht, ky territor ka një përdorim institucional dhe shërben si pjesë e infrastrukturës mbështetëse të burgut ekzistues. Pjesa specifike e truallit ku do të ngrihet spitali i ri përbëhet kryesisht nga një sipërfaqe e lirë (shesh), pjesërisht e mbuluar me bimësi barishtore spontane, e cila nuk shfrytëzohet për qëllime produktive, bujqësore apo pyjore. Trualli është pronë shtetërore në administrim të Ministrisë së Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe është i rrethuar e i siguruar konform regjimit të institucionit. Infrastruktura rrugore ekzistuese brenda territorit lejon aksesin e mjeteve, ndërsa sipërfaqja e parashikuar për ndërtim nuk ka objekte apo struktura të tjera që do të kërkonin shembje masive, duke e bërë atë të përshtatshme për zhvillimin e menjëhershëm të projektit pa ndryshuar destinacionin e përgjithshëm të zonës.

Hartoi raportin teknik:

Ing. Erjona Qatipi
Nr. Certifikate 5012 dt. 04/07/2013